VENDIM
Nr. 123, datë 2.3.2022

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun I, të vendimit nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 7, pas fjalëve "... (CFSP) 2021/2196, ..." shtohen "... (CFSP) 2022/265, (CFSP) 2022/267 (CFSP) 2022/329 dhe (CFSP) 2022/331 ...".

b) Pas pikës 24 shtohen pikat 25 dhe 26, me këtë përmbajtje:

"25. Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2014/512, "Për vendosjen e masave kufizuese, për shkak të veprimeve të Rusisë për destabilizimin e situatës në Ukrainë", të ndryshuar, sipas aneksit 25.

26. Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/266, "Për vendosjen e masave kufizuese në përgjigje të njohjes së zonave të kontrolluara joqeveritare të rajoneve Donetsk dhe Luhansk dhe urdhërimin e forcave të armatosura ruse në ato zona", të ndryshuar, sipas aneksit 26.".

2. Në aneksin 7, që përmendet në pikën 7, të kreut I, shtohen vendimet (CFSP) 2022/265, (CFSP) 2022/267, (CFSP) 2022/329 dhe (CFSP) 2022/331, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Pas aneksit 24 bashkëlidhur vendimit shtohen anekset 25 dhe 26, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama